


*Harundëjino*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE



**V E N D I M**

Nr. 353, datë 11.5.2016

**P Ë R**

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.83, DATË 3.2.2016,**  
**TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E KRITEREVE**  
**TË KRIJIMIT TË NJËSIVE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM**  
**NË SEKTORIN PUBLIK"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 26, të ligjit nr.114/2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Pika 4, e vendimit nr.83, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Njësitë publike që krijojnë njësinë e auditimit të brendshëm, sipas pikës 1, të këtij vendimi, nuk programojnë të kryejnë shërbimin e auditimit të brendshëm për njësitë e varësisë, të cilat kanë në strukturën e tyre organizative njësi të auditimit të brendshëm. Ky shërbim në njësitë e varësisë mund të kryhet në raste të veçanta me urdhër të titullarit të njësisë publike të organit epror."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**K R Y E M I N I S T R I**

**ED I R A M A**

MINISTRI I FINANCAVE

**ARBEN AHMETAJ**